LIGJ
Nr.10 370, datë 10.2.2011

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES KULTURORE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR NGRITJEN E NJË QENDRE KULTURORE DHE INFORMACIONI TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SOFJE DHE TË NJË QENDRE KULTURORE DHE INFORMACIONI TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË NË TIRANË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja kulturore ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për ngritjen e një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Shqipërisë në Sofje dhe të një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Bullgarisë në Tiranë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6898, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË BULLGARISË MBI NGRITJEN E NJË QENDRE KULTURORE DHE INFORMACIONI TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SOFJE DHE NJË QENDRE KULTURORE DHE INFORMACIONI TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË NË TIRANË

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, këtu quhen "palët kontraktuese",
Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese kanë shprehur pëlqimin e tyre për ngritjen e një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Bullgarisë në Tiranë dhe të një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Shqipërisë në Sofje, këtu në tekst të quajtura "qendrat kulturore dhe informative".

Neni 2

Qendrat kulturore dhe informative i zhvillojnë aktivitetet e tyre në kuadrin e termave të aprovuar nga kjo Marrëveshje dhe në pajtim me ligjet e shtetit, në territorin e të cilit ato ndodhen.

Neni 3

1. Palët kontraktuese sigurojnë hyrje të lirë në ambientet e qendrave kulturore dhe informative dhe në aktivitetet e organizuara prej tyre.

2. Emrat zyrtarë të qendrave kulturore dhe informative mund të përfshihen në pllakate, postera, dokumente dhe mund të përdoren në korrespondencë, në materialet e informimit dhe komunikimit.

3. Secila palë kontraktuese zbaton të gjitha masat e kërkuara, me qëllim që të garantojë funksionimin normal të qendrës kulturore dhe informative të palës tjetër kontraktuese në këtë Marrëveshje.

Neni 4

1. Qendrat kulturore dhe informative mund të zhvillojnë aktivitetet e mëposhtme:

a) Organizojnë një bibliotekë dhe sallë leximi në ambientet e tyre.

b) Nxjerrin dhe importojnë publikime që përmbajnë informacione mbi kulturën dhe shkencat në vendin e saj.

c) Organizojnë shfaqje filmash në dhe jashtë ambienteve të tyre, me asistencën e institucioneve të vendit pritës, kompetent në këtë fushë.

d) Organizojnë në ambientet e tyre aktivitete letrare, shkencore dhe të tjera, të shoqëruara me prezantime vizuale ose muzikore, sipas nevojës.

e) Organizojnë në ambientet e tyre ekspozita fotografish, grafikash, posterash, librash, veprash origjinale të artit dhe riprodhime të artit.

f) Japin shërbime informimi për qytetarët e interesuar të palëve kontraktuese, si dhe për qytetarët e vendeve të treta.

g) Nxjerrin dhe shpërndajnë informacion, buletine në lidhje me ngjarjet dhe aktivitetet e organizuara nga qendrat kulturore dhe informative, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të reja të informacionit.

h) Vazhdojnë shkëmbimin e programeve të televizionit dhe radios, në pajtim me marrëveshjet tashmë të zbatueshme të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të palëve kontraktuese.

2. Qendrat kulturore dhe informative mund të japin me qira dhe të shpërndajnë në publik falas materiale sipas pikës 1.g.

Neni 5

Gjatë përmbushjes së aktiviteteve të parashikuara në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, qendrat kulturore dhe informative respektojnë ligjet e shtetit, në territorin e të cilit ato ndodhen.

Neni 6

1. Qendrat kulturore dhe informative janë qendra publike dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohet nga secila palë kontraktuese.

2. Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtën të përfundojnë kontrata në vendet e tyre të pritjes, të nevojshme për funksionimin e tyre.

3. Me qëllim që të mbulojnë shpenzimet e tyre, qendrat kulturore dhe informative mund të gjenerojnë të ardhurat e tyre nga shfaqjet dhe ngjarjet e tjera kulturore.

4. Objektet për ekspozitat të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative në ambientet e tyre ose në salla të tjera, si dhe objektet e një natyre kulturore, si: librat, CD-të, kasetat video dhe audio mund të ofrohen për shitje vetëm me kusht që të jenë paguar detyrimet doganore, që mblidhen nga autoritetet doganore dhe të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm në vendin pritës.

Neni 7

1. Palët kontraktuese japin, mbi bazë reciprociteti, asistencë për identifikimin e ambienteve, ndërtesave dhe parcelave të tokës, të përshtatshme për aktivitetet e qendrave kulturore dhe informative. Termat për marrjen me qira ose përfitimin e këtyre ambienteve, ndërtesave ose parcelave të tokës përcaktohen në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të vendit pritës.

2. Qendrat kulturore dhe informative mund të pajisen me informacion audio-vizual, telekomunikacion dhe mjete të tjera, të kërkuara për zhvillimin e aktivitetit të tyre në pajtim me këtë Marrëveshje.

3. Palët kontraktuese, në pajtim me reciprocitetin dhe respektimin e legjislacionit të zbatueshëm në vendin pritës, i përjashtojnë qendrat kulturore dhe informative nga pagesa e detyrimeve doganore, përveç detyrimeve për formalitetet doganore të zhvilluara jashtë zyrave të tyre, të ngritura për këtë qëllim ose jashtë orarit të punës së organeve doganore, tarifat e magazinimit dhe shërbimeve të një natyre të ngjashme për mallrat e mëposhtme të importuara, që nuk janë destinuar për shitje:

a) Katalogët, posterat, njoftimet, programet, librat, pikturat, regjistrimet LP, materialet audio-vizuale, të kërkuara për funksionimin normal të qendrave kulturore dhe informative;

b) mallrat e importuara përkohësisht: pajisjet teknike, mobiliet dhe materialet, duke përfshirë automjetet e kërkuara për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative;

c) filmat që shfaqen në ambientet e qendrave kulturore dhe informative dhe jashtë tyre, në kuadrin e aktiviteteve të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative;

d) çdo material tjetër i një natyre kulturore ose informative, që kërkohet për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative.

Neni 8

Tatimi i të ardhurave të qendrave kulturore dhe informative rregullohet nga legjislacioni tatimor i vendit pritës, si dhe nga çdo marrëveshje e zbatueshme bilaterale ndërmjet Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

1. Palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me rritjen e numrit të personelit në qendrat kulturore dhe informative, si dhe për emërimet dhe largimet e anëtarëve të personelit.

2. Punësimi e marrëdhëniet juridike të punonjësve të qendrave përkatëse kulturore dhe informative, të cilët janë shtetas të vendit dërgues, rregullohen nga legjislacioni i punësimit dhe normat e sigurimeve shoqërore të atij vendi.

3. Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtë të punësojnë shtetas të vendit pritës, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të brendshëm.

Neni 10

1. Secila prej palëve kontraktuese, mbi bazën e reciprocitetit, u ofron individëve të personelit të qendrës kulturore dhe informative të palës tjetër, si dhe bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre që banojnë me ta, të gjitha lehtësitë, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, për lëshimin në kohë të vizave dhe të lejeve të qëndrimit nga vendi pritës.

2. Lehtësira të ngjashme u jepen edhe pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore brenda kuadrit të programeve të aktiviteteve të qendrave kulturore dhe informative.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me

konsultime ndërmjet palëve kontraktuese, si dhe nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë, nëpërmjet së cilës palët kontraktuese informojnë reciprokisht njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje zbatohet për një afat kohor prej pesë vjetësh. Vlefshmëria e saj zgjatet automatikisht për çdo periudhë pasuese pesëvjeçare, me kusht që asnjë prej palëve kontraktuese të mos e denoncojë atë me njoftim me shkrim deri në 6 muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Nënshkruar në Tiranë më 23.4.2008, në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rastin e mospërputhjeve në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.